


ANALIZË E KAPACITETEVE  
TË NDËRMARRJEVE SOCIALE  
NË MAQEDONINË E VERIUT

**STUDIM PËR POLITIKAT**







**USAID**  
ОД АМЕРИКАНСКИОТ НАРОД



Kjo analizë është përgatitur nga shoqata për hulumtim, kuminkim dhe për zhvillim – Pablik me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Mendimet e shprehura në këtë analizë u takojnë autorëve dhe nuk i shprehin qëndrimet e Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara Amerikane.

CIP – Katalogizim në poublikim

Biblioteka kombëtare dhe universitare “Shën Klimenti i Ohrit”, Shkup

334.72:364-3(497.7)

ILIJEVSKI, Klimentina

Analizë e kapaciteteve të ndërmarrjeve sociale në Maqedoninë e Veriut: studim për politikat / Autorë Klimentina Ilievski dhe Aleksandra Iloska. - Shkup : Shoqata e qytetarëve për hulumtim, komunikime dhe zhvillim Pablik, 2019. - 27 fq. : ilustrime.; 21 cm

Bibliografia: fq. 27

ISBN 978-608-66357-0-1

1. Iloska, Aleksandra [autore]  
a) Ndërmarrjet sociale - Analiza - Maqedonia  
COBISS.MK-ID 110334474

# ANALIZË E KAPACITETEVE TË NDËRMARRJEVE SOCIALE NË MAQEDONINË E VERIUT

## STUDIM PËR POLITIKAT

**Autorë:** Klimentina Ilijevska dhe Aleksandra Iloska  
**Analizë e një pjese të të dhënave:** Maja Ravanska  
**Grumbullimi i të dhënave:** Aneta Risteska, Maja Ravanska, Aleksandra Iloska  
**Këshilltare gjatë hulumtimit:** Katerina Mojançevska

# PËRMBAJTJA

Lista e tabelave dhe figurave .....	6
Lista e shkurtesave .....	6
1 HYRJE .....	7
1.1 Historiku i ndërmarrjeve sociale në Maqedoninë e Veriut .....	8
2 METODOLOGJIA DHE PËRSHKRIMI I EKZEMPLARIT .....	9
2.1 Ndërmarrjet sociale në Maqedoninë e Veriut: gjendja aktuale .....	10
3 ANALIZË E KAPACITETEVE TË NDËRMARRJEVE SOCIALE NË MAQEDONINË E VERIUT .....	11
3.1 Dimensioni sipërmarrës/ekonomik i ndërmarrjeve sociale .....	12
3.1.1 Sfidat në zhvillimin e dimensionit ekonomik .....	15
3.2 Dimensioni sociale .....	16
3.3 Menaxhimi i mirë .....	18
4 NDËRTIMI I KAPACITETEVE NË SEKTOR: SFIDAT DHE NEVOJAT .....	20
5 KONSTATIMI .....	22
6 REKMANDIME.....	25
6.1 Rekomandime për politikën publike .....	26
6.2 Rekomandime për biznesin tradicional (vetëm për të orientuarit ndaj përfitimit).....	26
6.3 Rekomandime për ndërmarrjet sociale .....	26
LITERATURA .....	27

---

## LISTA E TABELAVE, GRAFIKONËVE DHE E FIGURAVE

Fotografia 1: Shqyrtimi i sfidave të ndërmarrjeve sociale në zhvillimin e dimensionit ekonomik

## LISTA E SHKURTESAVE

**SH.P.K.:** Shoqatë me përgjegjësi të kufizuar  
**SH.P.K.NJ.P.:** Shoqatë me përgjegjësi të kufizuar të një personi  
**BE:** Bashkimi Evropian  
**EMES:** Rrjet internacional i hulumtuesve të ndërmarrjeve sociale  
**MPPS:** Ministria e Punës dhe Politikës Sociale  
**PR:** Marrëdhëniet me opinionin  
**NS:** Ndërmarrje sociale

---

## 1 HYRJE

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut zhvillimi i ndërmarrjeve sociale është në fillim. Koncepti paraqitet pak në një pjesë të politikës publike, mirëpo njohja politike e sektorit është larg njohjes përkatëse, strategjike dhe vizionare. Qeveria, për herë të parë në programin e vet të punës (2017-2020) e vendosi sipërmarrësinë sociale duke paraparë sjelljen e ligjit për sipërmarrësi sociale përmes së cilit do të lehtësohet qasja në tregun e punës për kategoritë e ndjeshme sociale të qytetarëve.

Parashihet edhe mundësia që grupet e ndjeshme ta menaxhojnë ndërmarrjen, të sjellin vendime për menaxhimin e të ardhurave të realizuara dhe për investimin e tyre për qëllime sociale. Në strategjitë zyrtare qeveritare, nga ana tjetër, koncepti sipërmarrësi sociale për herë të parë është vendosur në strategji më të gjera për bashkëpunim me sektorin qytetar (2012-2017) ku është paraparë masë më e përgjithshme për zhvillimin e konceptit më të gjerë: ekonomia sociale. Masa parasheh aktivitete të cilat në mënyrë eksplicite synojnë organizatat qytetare me aktivitete ekonomike, duke i lënë më pas modeltet e tjera të cilat e formojnë spektrin e ndërmarrjeve sociale. Vizioni i njëjtë është i përfaqësuar edhe në kuadër të strategjisë vijuese (2018-2020) në të cilën ndërmarrjet sociale shihen vetëm si mekanizëm për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare për sektorin qytetar.

**Rregullativa ligjore ekzistuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk i njeh dhe nuk i rregullon ndërmarrjet sociale dhe sipërmarrësinë sociale pasi akoma nuk ekziston mirëkuptim i përbashkët për konceptet.** Që të dy konceptet u paraqitën në diskursin e sektorit të tretë dhe në përgjithësi, ekziston konfuzion konceptual kur diskutohet publikisht për to. Zhvillimi i ndërmarrjeve sociale në Maqedoninë e Veriut lidhur me ngjarjet e fundit në sektorin e tretë, si, për shembull, mbështetjen financiare për shërbimet të cilat i ofrojnë organizatat qytetare, decentralizimi i sistemit për mbrojtje sociale dhe ndikimi i rritur i mbështetjes financiare që është në dispozicion nga bashkësia donatore.

**Entitetet të cilat e përbëjnë spektrin e ndërmarrjeve sociale në vend janë të llojllojshme.** Edhe krahas mungesës së formave specifike juridike për ndërmarrjet sociale, një pjesë e akteve ligjore ekzistuese mundësojnë themelimin dhe funksionimin e entiteteve që mund të njihen si ndërmarrje sociale, si, për shembull, organizata dhe fondacione qytetare, kooperativa, shoqata mbrojtëse, oda të zejtarëve, kooperativa bujqësore si edhe sektori joformal për grumbullimin e mbeturinave e ka potencialin të transformohet përmes sipërmarrësisë sociale.

**Gjatë vitit 2018/2019 Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut punoi në reformat në sistemin e furnizimeve publike dhe të mbrojtjes sociale, të cilat sigurojnë stimulimin e kornizës ligjore të mbrojtjes sociale. Me Ligjin për furnizime publike** (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 24/2019), në kornizën ligjore të vendit për herë të parë është rregulluar mundësia për vendosjen e furnizimeve të rezervuara. Ai hyri në fuqi nga 1 prilli 2019. Ligji për herë të parë e promovoi konceptin e furnizimeve sociale, i cili mundëson organ i dakorduar ta rezervojë të drejtën e pjesëmarrjes në procedurë për furnizimin publik të operatorëve ekonomik, qëllimi kryesor i së cilit është integrimi shoqëror dhe profesional të personave me pengesa në zhvillim ose të personave të grupeve të ndjeshme sociale, të cilat e riinvestojnë përfitimin për këtë qëllim, në pajtim me ligjin. Në këtë rast, të paktën 30 për qind e personave të punësuar tek operatori ekonomik janë persona me pengesa në zhvillim ose persona të grupeve të ndjeshme/përrjashtuara sociale. Më pas, ligji përcakton se operatori ekonomik duhet t'i plotësojë kushtet në vijim: 1) sigurimin e shërbimeve publike vetëm nga sfera e shërbimeve shëndetësore, sociale apo kulturore; 2) fitimi riinvestohet për shkak të realizimit të qëllimeve të organizimit në pajtim me ligjin; 3) struktura drejtuese apo e pronësisë së organizatës bazohet në pronësinë e të punësuarve, gjegjësisht kërkon pjesëmarrje aktive të të punësuarve, shfrytëzuesve apo palëve të interesuara. Me Ligjin e ri për mbrojtje sociale, i cili gjatë zbatimit të hulumtimit ishte në procedure kuvendore, parashihet angazhim më i madh i njëjësive të Vetëqeverisjes lokale në hartimin social të nevojave të qytetarëve në nivel lokal. Në sistemin e reformuar të mbrojtjes sociale parashihet zhvillimi i shërbimeve sociale të cilat do të sigurohen në shtëpinë e shfrytëzuesit, në bashkësi dhe në familje, si edhe shërbimet sociale inovative dhe intervente. Lidhur me sigurimin e shërbimeve sociale mundësohet përfshirja e vetëqeverisjes lokale, si edhe e shoqatave të qytetarëve, personave fizik dhe sektorit privat në sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve në bashkësi. Gjigjë-

sisht, të gjitha këto shërbime paraqesin mundësi për zhvillimin e ndërmarrjeve të reja sociale, të cilat do t'i kënaqnin nevojat e shërbimeve në nivel lokal.

Pritet reformat në nivel të politikave publike të kenë efekt ndaj ekosistemit në të cilin funksionojnë ndërmarrjet sociale në vend. Por, për momentin, ato ekzistojnë në një ekosistem të pazhvilluar në të cilin mungojnë kapacitetet që të adresohen sfidat vijuese dhe pengesat e ndërmarrjeve sociale. Analiza e zbatuar e kapaciteteve të ndërmarrjeve sociale jep shqyrtim detajues në kapacitetet ekzistuese të sektorit nga aspekti i qëndrueshmërisë ekonomike, kontributit ndaj shorëqisë, bashkësisl dhe shfrytëzuesve (dimensioni social) dhe praktika lidhur me menaxhimin e mirë. Analiza bazohet mbi kriteret e EMES (Rrjetit internacional të studiuesve të ndërmarrjeve sociale) për hartimin e ndërmarrjeve sociale me qëllim që rezultatet e marra të jenë të krahasueshme me studimet vijuese që zbatohen në nivel të BE-së. Më pas, konteksti i Maqedonisë krahasohet me kriteret minimale të secilës prej dimensioneve që të identifikohen fushat ku nevojitet progresi me qëllim të arritjes së harmonizimit të plotë.

## **1.1 HISTORIKU I NDËRMARRJEVE SOCIALE NË MAQEDONINË E VERIUT**


Praktika e parë e sipërmarrësisë sociale në Maqedoni është vërejtur që në vitin 1900, kur kanë qenë funksionale shumë shoqata të shumta vullnetare, kooperativa dhe forma të tjera të shoqërive autonome (Sivchev and Randelovic, 1966: 11). Aktiviteti i tyre dominues ka qenë publikimi i buletinëve informativ (Trajkovski et al., 1999). Në periudhën që pason janë identifikuar forma plotësuese të praktikës socio-sipërmarrëse si: kooperativa e parë konsumatore (1990), Oda e parë Ekonomike e Maqedonisë (e themeluar në vitin 1922) dhe kooperativat e rinisë (në vitin 1938). Megjithatë, paraardhësit e praktikës së ndërmarrjeve sociale në Maqedoni zhvillimin e tyre më të madh e kanë arritur në periudhën pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore (1945-1991)

Format me traditën më të gjatë, të cilat e kanë stimuluar zhvillimin e formave të reja të bashkëpunimit ekonomik, njëherësh duke e promovuar solidaritetin dhe vetëndihmesën, përfshijnë: 1) shoqëri mbrojtëse; 2) organizata sociale; 3) zanate. Në këtë periudhë janë identifikuar edhe bashkësitë e shumta lokale dhe rrjetet joformale dhe bashkëpunimet e qytetarëve (Trajkovski et al., 1999: 12). Të gjitha këto nisma mund të konsiderohn si trashëgimi pozitive, që e hap rrugën për paraqitjen e ndërmarrjeve të sotme sociale. Pas pavarësimit të Maqedonisë, tranzicioni nga ekonomia e planifikuar drejt ekonomisë së tregut është shoqëruar me probleme të intensifikuara ekonomike, politike dhe shoqërore. Si rezultat i kësaj, një pjesë e praktikës ekzistuese nga sfera e sipërmarrësisë sociale i vazhdoi aktivitetet e veta operative njëherësh duke e kultivuar trashëgiminë kulturore dhe vazhdimësinë e paraardhësve të vet, ndërsa entitetet e tjera, si, për shembull, kooperativat e të rinjve u zhdukën në tërësi.



# 2


## METODOLOGJIA DHE PËRSHKRIMI I EKZEMPLARIT



Hulumtimi për vlerësimin e kapaciteteve të ndërmarrjeve sociale ekzistuese në Maqedoninë e Veriut është e drejtuar nga shqyrtimi i potencialeve si edhe në pengesat e zhvillimit të këtyre entiteteve, ndërsa siguron edhe shqyrtim të ekosistemeve ekzistuese për zhvillimin e ndërmarrjeve sociale në vend. Studimi u zbatua në periudhën nga nëntori 2017 deri në mars të vitit 2018, ndërsa i përfshiu rajonin planor të Shkupit (20), atë Jugperëndimor (4), të Pellagonisë (4), Pollogut (2), Vardarit (2), Juglindor (4), Lindor (1) dhe Verilindor (2). Janë analizuar të gjitha ndërmarrjet sociale të evidentuara në bazën e Asociacionit për hulumtim, komunikime dhe për zhvillim “Pablik”, që i ndjek gjendjet në këtë fushë, i shënon dhe evidenton ndërmarrjet sociale të krijuara nga shoqatat e qytetarëve por edhe nga ndërmarrjet, mënyra e funksionimit të së cilave bazohet në kriteret për ndërmarrje sociale. Në kuadër të këtij studimi janë përfshirë edhe dy kooperativa. Për nevojat e këtij studimi janë bërë intervista me përfaqësues të 39 entiteteve të regjistruara, përmes hulumtimit cilësor me qëllim që sa më thellë të shqyrtohet zhvillimi i dimensionit të tyre social dhe ekonomik, si edhe struktura e tyre menaxhuese, ndërsa edhe të shqyrtohet mjedisi në vend që e mundëson zhvillimin e tyre. Me qëllim të marrjes së të dhënave gjithëpërfshirëse për ndërmarrjet sociale ishte shfrytëzuar pyetësi i gjysmëstrukturuar i zhvilluar për këtë studim.

# 3

## ANALIZË E KAPACITETEVE TË NDËRMARRJEVE SOCIALE NË MAQEDONINË E VERIUT – STUDIM PËR POLITIKAT



### 3.1 DIMENSIONI SIPËRMARRËS/EKONOMIK I NDËRMARRJEVE SOCIALE

**PËRKUFIZIMI I PËRGJITHSHËM:** Ndërmarrjet sociale kanë aktivitete ekonomike stabile dhe të vazhdueshme, ndërsa me këtë tregojnë karakteristika sipërmarrëse tipike, të cilat i kanë të përbashkëta me ndërmarrjet e tjera (EMES, 2018).

**KRITERI MINIMAL SIPAS PËRKUFIZIMIT TË EMES:** Ndërmarrjet sociale duhet të orientohen në mënyrë tregtare (të paktën 25 për qind e qarkullimit të përgjithshëm vjetor duhet të jetë prej aktivitetit ekonomik).

**APLIKIMI I KRITERIT NË KONTEKSTIN E MAQEDONISË:** Në përgjithësi, ndërmarrjet ekzistuese sociale në Maqedoninë e Veriut kanë biznes modele hibride. Qëndrueshmëria financiare paraqet sfidë për të gjithë, pa dallimin e formës juridike sipas të cilës janë regjistruar. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve sociale janë regjistruar si shoqata të qytetarëve dhe të ardhurat prej aktiviteteve ekonomike lëvizin prej një deri në 22 për qind të të ardhurave të përgjithshme vjetore. Që këtu, nevojitet përforsim plotësues i sektorit nga aspekti i zhvillimit të aftësive sipërmarrëse dhe promovimit të sipërmarrësisë jofitimprurëse si koncept, duke e përfshirë edhe zhvillimin e evidencës së aktiviteteve ekonomike në nivel të organizatës.

**Studimi i zbatuar e vërteton atë se në Maqedoninë e Veriut entitetet të cilat njihen si ndërmarrje sociale janë të regjistruara sipas formave të ndryshme juridike.** Megjithatë, format juridike më dominuese janë shoqatat e qytetarëve, të cilat janë në fillim me zhvillimin e aktiviteteve sipërmarrëse. Gjithsej 31 entitete në ekzemplar janë regjistruar si shoqata qytetare, pjesë plotësuese – si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, dy – si kooperativa (një si kooperativë bujqësore, ndërsa e dyta si kooperativë konsumatore) dhe një entitet është regjistruar si zejtar.

**Në përgjithësi, ndërmarrjet sociale në Maqedoninë e Veriut janë aktive në spektrin më të ngushtë të veprimtarive,** siç janë prodhimi dhe shitja e produkteve organike, duke e përfshirë edhe kozmetikën natyrale, produktet ushqimore autentike vendore dhe produktet e tjera, riciklimin dhe ripërdorimin. Entitetet, nga ana tjetër, që janë aktive në sigurimin e shërbimeve janë identifikuar në veprimtari si kujdesi për personat e moshuar, deinstitutionalizimi i personave me pengesa në zhvillim dhe aktivizimi i tyre, mbështetja e të varurve nga droga, alkooli dhe prej lojërave hazard, mbështetja dhe edukimi i grave shtatzëna dhe nënave gjidhënëse. Një pjesë e tyre janë përfshirë edhe në arsimin joformal, në kulturë dhe art, në aktivitete botuese.

**Në praktikë, ndërmarrjet sociale në vend kanë biznes model hibrid** dhe më pas të ardhurat prej aktiviteteve ekonomike varen prej formës juridike të entitetit. Thuhet se 70 për qind e ndërmarrjeve sociale të hulumtuara, krahas aktiviteteve ekonomike, kanë edhe aktivitete të tjera të cilat janë me orientim projektues dhe zbatohen përmes granteve. Entitetet, fokusi primar i së cilave është tek aktivitetet ekonomike, janë ato që janë regjistruar si shoqëri me pronësi të kufizuar (sh.p.k.) dhe sh.p.k.nj.p. (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të një personi), kooperativat. Përfaqësuesit e ndërmarrjeve sociale në vend me të cilat u realizua intervista, kryesisht, varen prej ndihmës së huaj donatorit, gjegjësisht 87,71 për qind punojnë me grante prej donatorëve. Ekziston mungesë e vërejtur e mbështetjes financiare nga vetëqeverisja lokale, Qeveria dhe prej institucioneve të tjera publike.

**Ndërmarrjet sociale të cilat janë regjistruar si organizata qytetare nuk mbajnë evidence të qarta në raport me të ardhurat që i realizojnë prej aktiviteteve ekonomike.** Një pjesë e tyre janë në fillim të funksionimit të tyre, ndërsa disa prej tyre produktet e tyre i shesin, kryesisht, në bazare, panaire dhe mjetet të cilat i marrin prodhuesit e tyre gjithmonë janë shumë modeste dhe paguhen me para të gatshme. Entitetet të cilat kishin mundësi t'i theksojnë të ardhurat e sakta prej aktiviteteve ekonomike evidentojnë të ardhura prej tyre që janë prej një deri në 22 për qind.

Në kuadër të ekzemplarit, është evidentuar një ndërmarrje sociale e regjistruar si shoqatë qytetarësh, e cila merr pjesë në zbatimin e procesit të deinstitutionalizimit, me ç'rast 90 për qind e të ardhurave është nga zbatimi i këtij shërbimi, blerës i së cilit është Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

***Marrim financa për zbatimin e procesit të deinstitutionalizimit. Për çdo shfrytëzues që e deinstitutionalizojmë i fitojmë nga 18.000 denarë në nivel mujor, që është larg shumës së mjaftueshme për mbulimin e të gjitha shpenzimeve të cilat lidhen me këtë person. Si organizatë nuk kemi kapacitete projektuese.***

(përfaqësues i NS nga rajoni planor i Vardarit)

Gjithsej 65 për qind e ndërmarrjeve sociale me të cilat ishte bërë intervista kanë persona të punësuar. Ndërmarrjet sociale ekzistuese në vend janë entitete të vogla, me numër të vogël të të punësuarve, që lëvizë prej një deri në pesë persona. I vogël është numri i NS të cilat punësojnë mbi pesë persona, ndërsa akoma më i vogël i atyre të i punësojnë mbi 15 persona. Në kuadër të këtyre entiteteve janë punësuar gjithsej 125 persona prej të cilëve 79 gra dhe 46 burra, me çka pjesa më e madhe e tyre janë të moshës prej 29 deri në 45 vjeç dhe 221 persona të angazhuar me honorare prej të cilëve një pjesë janë të angazhuar vazhdimisht, një pjesë me projekte ose në mënyrë sezonale.

- Këto entitete promovojnë llojllojshmëri në strukturën e të punësuarve edhe nga aspekti i përkatësisë etnike edhe nga aspekti i arsimit. Në mjediset e përziera etnike, struktura e të punësuarve sipas nacionalitetit është e përzier – maqedonas, shqiptarë, romë, vllahë, por, megjithatë dominon kombësia maqedonase. Në ndërmarrjet në të cilat ka mbi pesë të punësuar vërehet llojllojshmëri lidhur me shkallën e arsimit të përfunduar – nga persona pa arsim të përfunduar të mesëm, me arsim të mesëm të përfunduar, persona me arsim të lartë, me magjistraturë dhe doktorate, por, megjithatë, dominon grupi i të punësuarve me arsim të lartë.

Shfrytëzimi i masave aktive mbetet potencial i pashfrytëzuar për ndërmarrjet sociale në Maqedoninë e Veriut. Planet e reja operative mundësuan një sërë masash të cilat kanë mundur t'i shfrytëzojnë entitetet me aktivitet ekonomik, si: punë praktike, punësim të subvencionuar dhe mbështetje për vetëpunësim, hapjen e mundësive të reja për punë për të gjithë, masë për punësimin e personave me invaliditet, megjithatë janë shfrytëzuar vetëm nga e 30,78 për qind e entiteteve në hulumtim.

***Trajnimet që i kemi nga APRM ishin jopërkatëse, nuk e di se si na llogarisin aq të padijshëm. Masat e tyre mbrojtëse janë pengesë. Unë duhet të gjej furnizues, i cili do të më dërgojë profaturë, të cilën duhet ta miratojnë në UNDP, të pritët me ditë dhe më nuk dihet nëse shitësi e ka atë që kemi nevojë. Burokraci e vështirë. Pasi ta miratojnë profaturën, unë duhet ta dërgoj tek furnizuesi, ndërsa më pas pritët një muaj UNDP të paguaj.***

(përfaqësues i NS nga rajoni planor i Shkupit)

Një pjesë e ndërmarrjeve sociale kanë pasur dëshirë të shfrytëzojnë masa, por nuk ia kanë dalur për shkak të pengesave burokratike, mungesës së kapaciteteve dhe njohurive si edhe mosplotësimin të kushteve të dhëna për shfrytëzimin e masave.

***Shoqata jonë asnjëherë nuk ka pasur të punësuar, por tenton t'i përforcojë gratë vetë të hapin biznesin e tyre. Ndërsa ka edhe diçka problematike tek masat aktive, përshtypja ime është se shpesh keqpërdoren dhe se është dakorduar se ku do të ndahen. Gratë kanë ide dhe dëshirojnë të punojnë, vetëm se askush nuk ua jep mundësinë të dëshmohen. Na duhet pak mbështetje prej sektorit të biznesit dhe prej Vetëqeverisjes Lokale.***

(përfaqësuese e NS nga rajoni Jugperëndimor)

Në përgjithësi, ndërmarrjet sociale nuk janë konkurrencte në tregun e furnizimeve publike. Vetëm një pjesë e vogël e ndërmarrjeve sociale aplikojnë për tenderë për furnizime publike dhe nuk i shohin furnizimet publike si burim i financimit dhe sigurimit të qëndrueshmërisë ekonomike.

**Jemi regjistruar përmes sistemit për funrizime publike, por gjithçka bie në ujë kur të vihet çmimi më i ulët. Ne punojmë me kategori të ndjeshme dhe kemi zbrazëti në produkt. Duhet në çmim t'i përllongarisim edhe asistentët të cilët punojnë me personat me aftësi të kufizuara.**

(përfaqësues i NS nga rajoni i Shkupit)

Në 35 për qind të ndërmarrjeve sociale të ekzemplarit me të cilat ishte bërë intervistë nuk ka të punësuar. Një pjesë e tyre kanë vendosur ta mbulojnë kompensimin me honorar për shkak të parregullshmërisë së të ardhurave, ndërsa disa punojnë në bazë solidare (religjioze), me ç'rast tek entiteti tjetër qasja të punohet vetëm në mënyrë vullnetare është mjaft e shprehur.

**Jemi këtu pasi dëshirojmë të ndihmojmë. Qendra na i mbulon të ardhurat për jetesë, por nuk punojmë për kompensim. Ne jemi të krishterë, e bëjmë këtë me dashuri. Edhe unë kam qenë i varur dhe falë Zotit, paska pasur jetë. Tani edhe ne dëshirojmë të ndihmojmë, siç na ka ndihmuar dikush neve.**

(përfaqësues i NS nga rajoni planor i Shkupit)

Pothuajse 70 për qind e ndërmarrjeve sociale në ekzemplar janë ndërmarrje sociale për integrim pune, me ç'rast sigurojnë punësim dhe/apo angazhim pune për kategori të qytetarëve në nevojë: persona me pengesa mendore dhe fizike, pjesëtarë të komunitetit LGBTI, romë, prindër vetëushqyes, viktime të dhunës në familje, persona me probleme psikike. Gjashtë prej tyre punojnë në programe për mbështetjen e fitimit të shprehive të shëndetshme jetësore dhe kryesisht e shfrytëzojnë qasjen individuale, ndërsa shtatë zhvillojnë trajnime në pajtim me nevojat e personave të përfshirë në procesin e integritimit. NS të tjera nuk kanë programe të strukturuar për mbështetjen e personave në nevojë, përveç mundësinë që ua japin për përfshirjen në punë.

**Në mesin e të punësuarve kemi nënë kryefamiljare me tre fëmijë, nënë të një të varuri nga droga, të infektuar me HIV, dy transeksualë, të cilët janë përjashtuar nga bashkësia, pjesëtarë të familjeve të rrezikuara, të cilët nuk kanë kurrfarë të ardhura dhe janë pa arsim. Kryeisht punojnë si ndihmës në kuzhinë, lajnë emë, ndihmës të kuzhinierëve. Kuzhinierët dhe recepcionerët janë profesionistë. Pagën e kanë minimale, siç rregullohet me ligj, por është e rëndësishme sepse janë siguruar gjatë orarit të plotë dhe që janë aktive dhe të punësuar.**


(përfaqësuese e NS të rajonit planor Jugperëndimor)

Numri më i madh i entiteteve për integrim në punë e theksojnë nevojën e njohurive plotësuese lidhur me proceset integruese.

**Gjithmonë janë të nevojshme trajnime dhe shkëmbim përvojash. Para tre – katër vitesh nuk e dinimin se personat me pengesa mendore mund të punojnë, derisa nuk shkuam në një organizatë në Angli dhe e pamë se është e mundur.**

(përfaqësuese e një organizate të rajonit planor Verilindor)

## 3.11 DIMENSIONI SIPËRMARRËS/EKONOMIK I NDËRMARRJEVE SOCIALE



Fotografia 1: Shqyrtimi i sfidave të ndërmarrjeve sociale në zhvillimin e dimensionit ekonomik

Ndërmarrjet sociale në vend janë me kapacitete shumë të vogla për prodhimin dhe dhënie të shërbimeve. Pjesa më e madhe NS, gjegjësisht 58,79 për qind kanë zhvilluar biznes plane përmes mbështetjes së programeve për zhvillimin e ndërmarrjeve sociale në vend, por nuk udhëhiqen si të konsiderueshme në punën e tyre në pajtim me këto dokumente. Një pjesë e vogël e tyre janë të kënaqur prej biznes planeve të veta dhe theksojnë se kanë kontribuar për zhvillimin e NS të tyre.

***Kam pasur mentor të shkëlqyer, e kam zgjedhur nga lista e UNDP-së. Kemi bërë një plan të detajuar dhe sinqerisht pati ndikim në punën tonë.***

(përfaqësues i NS nga rajoni planor i Shkupit)

Pjesa më e madhe ndërmarrjeve ekzistuese kanë problem me plasimin e produkteve të tyre, nuk kanë kanale të definuara të shitjes, ndërsa informacioni për produktet dhe shërbimet e tyre shpesh transmetohet nga njeriu tek njeriu, pa strategji të zhvilluar për shitje. Më shumë se gjysma e ndërmarrjeve me të cilat është bërë intervistë nuk janë të kënaqura me shitjen e tyre. Resurset e kufizuara infrastrukturore dhe në njerëz si edhe mungesa e makinave, kryesisht i pamundëson që t'i arrijnë planet e tyre. Numri më i madh i entiteteve që nuk janë të kënaqura nga shitja e produkteve dhe shërbimeve të veta më shumë janë të orientuara nga marrja e donacioneve, sesa drejt zhvillimit të aktiviteteve ekonomike.

Pjesa më e madhe e NS ekzistuese theksuan se nuk kanë kapacitet për prodhim më të madh dhe shitjen apo ofrimin e shërbimit. Ata, që kanë kapacitet sqarojnë se mbeten në nivelin e njëjtë të shitjes për shkak të pamundësisë që t'i plasojnë produktet dhe shërbimet. Si pengesa plotësuese për zhvillimin e tyre i theksojnë mungesën e investimeve në ekonominë sociale, të cilën vlerësojnë se mund ta marrin prej komunës, mungesën e resurseve njerëzore, njohuri të pamjaftueshme për zhvillimin e biznesit, marketingun e pamjaftueshëm dhe promovimin por edhe pasivitetin nga ana e tyre, gjegjësisht zhvillimin e papërshtatshëm të aktiviteteve ekonomike dhe varësinë prej granteve. **Nga ana tjetër, vetëm 20 për qind e ndërmarrjeve sociale qartë theksojnë se çfarë investimi u nevojitet**, si blerja e makinave, hapja e repartit kryesor ose plotësues për prodhim, hapja e laboratorit me certifikatë dhe hapja e depose me kushte përkatëse për deponim.

**Gjithsej 74, 35 për qind e ndërmarrjeve sociale me të cilat ishte bërë intervistë nuk e njohin rëndësinë e ndërtimit të brendit** apo sqarojnë se nuk kanë kohë për një aktivitet të tillë edhe krahas aktiviteteve të tjera me të cilat merren. Një pjesë e vogël e tyre, gjegjësisht vetëm 15,38 për qind e ekzemplarit, vetë tentojnë të bëjnë hapa në këtë drejtim, edhe pse nuk ekziston të kuptuar të qartë të nevojës, ndërsa në të njëjtën kohë, tregojnë edhe për kufizimet financiare. Ndërmarrjet sociale në vend, kryesisht, reklamohen në mediat sociale, gjegjësisht gjithsej 56, 41 për qind prej tyre. Një pjesë shumë e vogël e tyre shfrytëzojnë vegla për marrëdhënie me opinionin. Theksojnë se strategjia më e suksesshme e marketingut është nga njeriu tek njeriu. Një numër i vogël midis tyre përpunojnë broshura dhe fletushka me produkte dhe shërbime të tyre.

**Në përgjithësi, tek ndërmarrjet sociale të hulumtuara mungon vizion dhe lidërsip.** Ekziston mungesë e vetëdijes se sipërmarrësinë që e praktikojnë gjegjësisht është, lidërsipi i ri, i cili ka kapacitet ta ndryshojë zhvillimin lokal në vend. Ata theksojnë se u nevojitet mbështetje financiare që më mire ta zhvillojnë biznesin, por nuk munden deri në fund ta shpjegojnë qartë në aspektin strategjik se si do ta ruajnë biznesin e tyre. Një pjesë e tyre, nga ana tjetër, kanë vizione të tyre, por janë pasiv në realizimin e ideve të tyre. Këto, janë kryesisht organizata më të vogla të lëvizura nga persona të cilët punojnë në mënyrë paralele (janë të punësuar) në entitete të tjera, ose, organizata të cilat kryesisht punojnë me grante, ndërsa tentojnë ta zhvillojnë edhe pjesën e tyre ekonomike.

### 3.2 DIMENSIONI SOCIAL

**PËRKUFIZIMI I PËRGJITHSHËM:** Dimensioi social është përkufizuar me qëllimin e entitetit dhe/ apo me produktin/shfrytëzimin e bërë.

**QËLLIMI:** Ndërmarrjet sociale duhet të kenë qëllim të përkufizuar shoqëror eksplicit, t'i shërbejnë bashkësisë apo një grupi specifik. Termi “shoqëror” duhet të shqyrtohet në kuptimin më të gjerë dhe të përfshirë sigurimin e shërbimeve kulturore, shëndetësore dhe arsimore, si edhe shërbime për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Përmes promovimit të interesit të përgjithshëm, NS e tejkalojnë orientimin tradicional ndaj pronarëve dhe aksionarëve.

**PRODUKTI:** Në raste kur NS nuk krijon produkt përmes integritit social dhe të punës së kategorive të qytetarëve në nevojë, kjo duhet të sigurojë produkt/shërbim që ka vlerë shoqërore.

**KRITER MINIMAL SIPAS PËRKUFIZIMIT TË EMES:** Qëllimi shoqëror duhet të përkufizohet qartë në legjislaturën kombëtare, në statusin e NS apo në dokumente të tjera përkatëse.

**APLIKIMI I KRITERIT NË KONTEKSTIN E MAQEDONISË:** Dimensioi shoqëror i ndërmarrjeve sociale, gjegjësisht është prej tre dimensioneve më të zhvilluara sipas të cilave shënohen ndërmarrjet sociale në Maqedoninë e Veriut. Pothuajse 56,41 për qind e ndërmarrjeve sociale të hulumtuara kanë mision të dyfishtë shoqëror, gjegjësisht në të njëjtën kohë e theksojnë problemin me tregun e punës joinkuziv dhe me papunësinë e grupeve të ndryshme të ndjeshme dhe kontribuojnë në ruajtjen e mjedisit jetësor.



Misionet e ndërmarrjeve sociale në Maqedoninë e Veriut janë në drejtim të realizimit të ndryshimit shoqëror dhe krijimit të mundësive të barabarta për target grupet me të cilat punojnë.

Pothuajse 56,41 për qind e ndërmarrjeve sociale të studiuara kanë mision të dyfishtë social, gjegjësisht njëherësh e theksojnë problemin me tregun e punës joinkluziv dhe me papunësinë e grupeve të ndryshme në nevojë dhe kontribuojnë për ruajtjen e mjedisit jetësor. Aktivitetet në sferën e mbrojtjes së mjedisit jetësor lëvizin nga kultivimi dhe shitja e ushqimit të patrajtuar kimikisht, zgjidhja e ushqimit të tepërt, veshjes dhe mobileve që nuk përfundojnë në mbeturina, riciklimin e mbeturinave plasitke dhe ngritjen e vetëdijes për mjedis jetësor përmes arsimit joformal. Ndërmarrjet e tjera sociale janë fokusuar nga dhënia e shërbimeve si servise për ndihmesë dhe për mbështetjen e lehonave, personave të moshës së tretë, të qenve endacakë, ndikojnë në uljen e shënimit në raport me problemet me shëndetin mental, uljen e diskriminimit ndaj personave me pengesa në zhvillim, ngritjen e vetëdijes për ruajtjen e traditës.

**Që këtu, mund të konstatohet se ndërmarrjet sociale ekzistuese në vend punojnë në zgjidhjen e problemeve ekzistuese shoqërore dhe në sigurimin e serviseve të nevojshme në nivel lokal.** Më pas, ndërmarrjet sociale të identifikuara që në zhvillimin e tyre udhëhiqen nga misioni i tyre. Pothuajse 65 për qind e ndërmarrjeve sociale në studim motivimin për themelimin e tyre e identifikojnë në nevojën që të integrohen dhe të prëforcohen qytetarët ekonomik joaktiv, si gra, prindër vetëushqyes, persona me pengesa në zhvillim, persona me problem në shëndetin mental, romë, qytetarë të rrezikuar social etj. Një pjesë e ndërmarrjeve sociale janë zhvilluar nga pjesëtarët e vetë grupeve të nevojshme, që tregojnë për një dinamikë të zhvillimit të ndërmarrjeve sociale, e cila ka të bëjë me kapacitetin e shoqërisë për t'u vetëorganizuar.

***Margjinalizimi tek prindërit vetëushqyes, kryesisht, është rezultat i problemit ekonomik. Ai është kyç. Këto familje janë ekonomikisht të dobëta për shkak të ignorimit të institucioneve shtetërore. Mënyra e vetme për përforcimin e tyre është dhënia e mundësisë të përfshihen në aktivitetin ekonomik.***

(përfaqësues i NS nga rajoni planor i Shkupit)

***Shumë prej grave nuk kanë punuar gjatë gjithë jetës, janë marrë me bujqësi, tani varen nga burri. Gruaja ka punuar, por nuk ka fusha në emër të saj, nuk e ka fituar të drejtën, nuk ka paguar kontribute dhe është person që e mbajnë. Shpesh më janë ankauar se i fajësojnë për gjithçka, për gjithçka që harxhojnë, ndërsa tërë jetës punojnë dhe mendova se si mundet këto gra të marrin ndonjë denar plus. E pashë shpalljen e “Smart start” dhe u paraqita. Tani e kemi zhvilluar tregimin për përforcimin ekonomik të grave që punojnë në bujqësi, ndërsa varen prej burrave të tyre.***

(përfaqësues i NS nga rajoni planor Juglindor)

***Personat me pengesa me të cilët punojmë kanë aftësi të ndryshme, por të pashfrytëzuara. Sikur të futeshin në programe për rehabilitim profesional, sikur të trajnosheshin për ndonjë aftësi të caktuar pune, mund të dalin në tregun e hapur të punës. Prandaj na nevojitet ndërmarrja sociale e jonë. Këtyre personave, nga ana tjetër, të cilëve ju duhet ndihmë dhe mbështetje, këta do të mbeten të veprojnë në kuadër të ndërmarrjes sociale.***

(përfaqësues i NS nga rajoni planor Verilindor)

### 3.3 MENXHIMI I MIRË

**PËRKUFIZIMI I PËRGJITHSHËM:** Për t'u identifikuar nevojat dhe për t'u përfshirë të gjithë faktorët e duhur në hartimin e zgjidhjeve adekuate, ndërmarrjet sociale duhet të kenë strukturë specifike të pronësisë dhe modele të menaxhimit që lejojnë aktorët të marrin pjesë në nivele të ndryshme. NS kufizon në mënyrë eksplicite shpërndarjen e fitimeve dhe ekziston një ndalim për transferimin e pasurive. Kufizimi i shpërndarjes së fitimit synon të sigurojë mbrojtjen e interesit të përgjithshëm dhe mund të operacionalizohet në shumë mënyra (EMES, 2018)

**KRITERI MINIMAL SIPAS PËRKUFIZIMIT TË EMES:** NS duhet të sigurojnë se interes e të gjitha palëve të involvuara janë të përfaqësuar në mënyrë adekuate në proces

**APLIKIMI I KRITERIT NË KONTEKSTIN E MAQEDONISË:** Në Maqedoninë e Veriut, mungojnë njohjet sociale të menaxhimit të mirë si një koncept dhe kapacitete shoqërore për zbatimin e tij. Menaxhimi i mirë formalisht praktikohet vetëm në nivelin e entiteteve në të cilat përfshihet korniza ligjore sipas të cilës është regjistruar, siç është rasti me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet dhe Ligjin për Kooperati

**Në përgjithësi, menaxhimi i mirë në ndërmarrjet sociale në Maqedoninë e Veriut varet nga forma ligjore në të cilat është regjistruar.** NS të regjistruara si OJQ, në hulumtim janë 69,23 për qind e subjekteve të zbatojnë parimet e menaxhimit të mirë në përputhje me kornizën ligjore si: kuvendi, bordi drejtues, kryetari i shoqatës dhe/ose drejtori ekzekutiv, ndërsa disa organizata kanë edhe bordin mbikëqyrës. Megjithatë, më shumë se gjysma e entiteteve shpjeguan se disa nga trupat janë formalisht dhe në praktikë përballen me një mungesë të kapaciteteve njerëzore që këto organe të funksionojnë.

**Forma ligjore gjithashtu i rregullon edhe parimet e tjera të menaxhimit të mirë, si ndalimi i transferimit të pronës së subjektit juridik, rregullimi dhe shpërndarja e fitimeve.** Korniza ligjore për shoqatat e qytetarëve dhe fondacioneve dhe korniza ligjore që e rregullon punën e kooperativave ndalojnë transferimin e pronës. Ndërmarrjet e tjera sociale, që veprojnë sipas Ligjit të Shoqatave tregtare, nuk kanë kufizime të tilla lidhur me transferimin e pronës.

Përveç kësaj, në Maqedoninë e Veriut, asnjë nga kornizat ekzistuese ligjore nuk e rregullon raportin e pagave ndërmjet menaxhimentit dhe punonjësve, prandaj nuk ka mekanizma për rregullimin e shpërndarjes indirekte të fitimeve. Në këtë vend, shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet kanë një ndalim të qartë për shpërndarjen e fitimeve të menaxhimit dhe palëve të interesuara. Fitimet, në përputhje me ligjin, duhet të riinvestohen për kryerjen e misionit. Kooperativat, megjithatë, në përputhje me Ligjin e Bashkëpunimit, gjithashtu mund të ndajnë disa nga fitimet e tyre për një qëllim tjetër, me ç'rast çdo vit të paktën pesë për qind e fitimeve duhet të investohen në fondin rezervë të kooperativës.

**Në përgjithësi, tek ndërmarrjet sociale me të cilat u zhvillua intervista, nuk kanë procedura të brendshme për rregullimin e menaxhimit të brendshëm dhe vendimmarrjes.** Vetëm ndërmarrjet më të mëdha sociale, të cilat kanë punonjësit e tyre, kanë zhvilluar procedura, por disa prej tyre theksojnë se ato dështojnë gjatë zbatimit të tyre në praktikë.

***Kemi shumë procedura. Disa prej tyre praktikohen dhe një pjesë mezi i pranojmë. Punë e maqedonasit, e dini, siç respektohen ligjet në shtet ashtu edhe procedurat në organizata.***

(përfaqësues i NS nga rajoni planor Juglindor)

Entitetet e regjistruara si sh.p.k. dhe sh.p.k.nj.p. kanë mision social të qartë, pronar apo pronarë, qëllimi i së cilave është krijimi i biznesit të qëndrueshëm por asnjëri prej tyre nuk ka zhvilluar procedura për menaxhimin participues dhe prë ta ky concept mbetet potencial i pashfrytëzuar.

**Pjesa më e madhe e entiteteve të hulumtuara, gjegjësisht 71,79 për qind, nuk kanë strukturë organizative të definuar, sistematizim të vendeve të punës dhe matjen e karakteristikave të të punësuarve.** Ato që kanë strukturë organizative të zhvilluar, kryesisht janë shoqata më të mëdha të qytetarëve me qëllime strategjike të definuara qartë, kooperativa, por edhe entitete të regjistruara si firma.

**Ndërmarrjet sociale me të cilat është bërë intervistë e njohin rëndësinë e ndërtimit të partneritetit me përfaqësues të vetëqeverisjes lokale, pushtetit qendror, bashkësive fetare dhe sektorit të biznesit.** 51 për qind e ndërmarrjeve sociale kanë bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale, si mbështetje në ndërtimin e kapaciteteve në nivel lokal dhe zbatimit të programeve inkluzive. Vetëm tri komuna në vazhdimësi, në nivel vjetor sigurojnë mbështetje financiare për aktivitetet e ndërmarrjeve sociale të cilat punojnë me persona të ndjeshëm të cilët paralelisht zhvillojnë edhe aktivitete ekonomike në të cilat i përfshijnë këta persona.


Gjithsej 30 për qind e ndërmarrjeve kanë arritur të zhvillojnë bashkëpunim me pushtetin qendror, i cili kryesisht bazohet në pjesëmarrjen e grupeve dhe trupave të punës, para së gjithash në sferën e politikës sociale, punën e dokumenteve strategjike dhe krijimin e politikës. Pesë për qind e ndërmarrjeve sociale bashkëpunojnë me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, gjegjësisht Ministria paguan/bashkëfinancon për shërbimin që e japin këto entitete. 7,6 për qind plotësues të këtyre entiteteve realizojnë bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, ndërsa edhe pesë për qind me Ministrinë e Ekonomisë. Vetëm 10 për qind e ndërmarrjeve sociale kanë bashkëpunim të mirë me organizatat fetare, të cilat kanë të bëjnë me ndarjen e tokës së përpunueshme për shfrytëzimin e donacioneve për ushqim dhe veshje, sigurimin e mjeteve në të holla për aktivitete. 33 për qind nga NS, kanë bashkëpunim të caktuar me ndërmarrjet, por vetëm tek 10 për qind e tyre ky bashkëpunim është i vazhdueshëm.

***Biznesi lokal jo vetëm se punëson shfrytëzues tanë, të cilët paraprakisht kanë qenë aktiv në NS tonë, por shpesh na sjellë edhe ushqim, mjete për higjienë, drake, dhuron material pune.***  
(përfaqësues i NS të rajonit Jugperëndimor)

**Bashkëpunimi i ndërsjellë i ndërmarrjeve sociale është ende në nivelin bazë.** Ato kryesisht bashkohen me qëllim të përfaqësimit dhe lobimit për qëllime të përbashkëta, shkëmbime të shërbimeve dhe produkteve, sigurimin e promovimit të produkteve dhe shërbimeve, angazhohen në aktivitete të përbashkëta, ndarjen e hapësirave të punës, ndihmën në ndërtimin e kapaciteteve, realizojnë partneritete gjatë shitjes. Disa prej tyre shpjegojnë se e mbështesin njëri-tjetrin, por nuk kanë ndonjë bashkëpunim specifik dhe të përcaktuar qartë midis tyre. Nga ana tjetër, përvoja nga vendet e tjera në Bashkimin Evropian konfirmon se rrjetëzimi dhe ekzistenca e mekanizmave për mbështetjen e ndërmarrjeve sociale që janë jo-monetare janë të një rëndësie të madhe për ndikimin e tyre. Prandaj, krijimi i një rrjeti kombëtar të ndërmarrjeve sociale duhet të jetë një prioritet.

# 4

## NDËRTIMI I KAPACITETEVE NË SEKTORIT: SFIDAT DHE NEVOJAT



Ndërmarrjet sociale prej tetë rajoneve e kanë pare nevojën e ndërtimit të kapaciteteve të tyre dhe 95 për qind e tyre kanë vizituar trajnime për zhvillim. Si efikase për zhvillimin e tyre institucional i vlerësojnë vizitat studimore dhe konsultimet e drejtpërdrejta, gjegjësisht takimet mentore. Një pjesë e trajnimeve që i kanë vizituar i vlerësojnë si joefikase duke theksuar se përsëriten, fokusohen në vetëm një segment (duke e marrë parasysh biznes-komponentin, pa u marrë parasysh misioni shoqëror).

***Kur u thoshim se nuk mundet kështu, se punojmë sipërmarrësi sociale, ata ishin në anën e kapitalizimit të forte, me mesazh se duhet t'ua marrë paratë klientëve. Ne përgjigjemi se në këtë rast do të merreshin me diçka tjetër, ndërsa se tregimet tona janë më ndryshe.***

(përfaqësues i NS të rajonit planor të Shkupit)

Theksojnë se rritet numri i trajnimeve në dispozicion për zhvillimin e kapaciteteve të sektorit, megjithatë në të njëjtën kohë e theksojnë mungesën e mbështetjes në pajtim me nevojat vijuese, pengesat dhe sfidat.

***Tani më duhet mbështetje financiare, asgjë më shumë se kaq. Mendoj se duhet të pauzojmë duke folur, e dime kush jemi dhe duhet të punojmë. Të gjithë paraqitemi në vende të njëjta dhe idenë e paraqesim vetë. Tani për mua është e rëndësishme nëse ekziston dikush që do të mi mbështesë idetë, ato duhet të zbatohen.***

(përfaqësues i NS nga rajoni planor i Shkupit)


**Disa ndërmarrje sociale kanë projeksione në cilin sektor duhet të avancohen:**

planifikimin dhe zhvillimin e biznesit, marketingut, komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun, duke krijuar një emër të njohur, shitje përmes internetit, formave ligjore dhe mundësitë, ndërsa disa e theksojnë nevojën për përmirësim në fushën në të cilën ata veprojnë - prodhim organik me certifikatë, menaxhimin e mbeturinave dhe ekonomi qarkuese, zhvillimin dhe rritjen profesionale të grupit të synuar, të arsimit të të rriturve, dhe njohuri profesionale për ndihmë mjekësore për të varurit në situata krize. Si pengesa kryesore i theksojnë mungesën e investimeve në zonë, jointerësimin e shtetit për të siguruar përfitime për punën e këtyre entiteve (të ndajë buxhet për kontributet dhe/apo hapësirë), mungesën e kornizës ligjore, mungesën e vetëdijes tek opinion, mungesën e resurseve njerëzore.

*Shumë ligje duhet të ndryshohen dhe institucionet të bëhen më të hapura për NS. Tani, sektori civil e di se çfarë është një ndërmarrje sociale, por jo institucionet. Për shembull, duhet të bëj një elaborat për sigurinë në punë për çdo përdorues. Punoj me kategori të prekshme, por si një përdorues final kam një gjysh i cili ka një shtëpi. A kam aftësinë për të bërë një elaborat mbi sigurinë në punë për çdo përdorues? Inspektorët, ndërkohë, punojnë sipas planit të tyre që nuk kanë elemente të veçanta për kategoritë sociale.*

# 5

## KONSTATIM



Hulumtimi që është objekt i kësaj analize konfirmon se ndërmarrjet ekzistuese shoqërore përballen me sfida të shumta, duke filluar nga procesi i regjistrimit, përmes sigurimit të qëndrueshmërisë financiare, mungesën e kapitalit njerëzor dhe kapaciteteve që do t'i bëjnë ata konkurrues në tregun e hapur, mungesën e njohjes politike, instrumenteve të reja financiare dhe mekanizmave mbështetëse, në përputhje me fazën e zhvillimit ku ndodhen. Është e nevojshme të përmirësohen kapacitetet e ndërmarrjeve shoqërore për të rritur konkurrueshmërinë e tyre në tenderët publikë, përndryshe, furnizimet e parapara të rezervuara në Ligjin e ri për furnizime publike do të mbeten një mundësi dhe potencial i papërdorur. Përveç kësaj, ndërmarrjeve sociale duhet t'u sigurohet qasje në një grup më të gjerë shërbimesh, të cilat do t'u mundësojnë atyre të përgatiten për investime.

### **EDIMENSIONI EKONOMIK**

Formë juridike dominuese e subjekteve që njihen si ndërmarrje sociale në Maqedoninë e Veriut është shoqatë e qytetarëve ku në fillim është zhvillimi aktiviteteve sipërmarrëse. Përveç kësaj, hasen forma të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe kooperativa, dhe vetëm një pjesë e vogël janë zejtarë. Ndërmarrjet ekzistuese sociale në vend janë njësi të vogla, me pak punonjës, duke filluar nga një deri në pesë persona. I vogël është numri i subjekteve që punësojnë më shumë se pesë persona, madje edhe më pak ata që punësojnë më shumë se 15 persona. Brenda këtyre subjekteve, më shpesh janë të punësuar gra se burra, shumica prej tyre janë të moshës 29-45 vjeç. Numri i personave që janë të angazhuar me honorar, nga të cilat një pjesë janë të angazhuara në mënyrë të përhershme, një pjesë pjesërisht ose në mënyrë sezonale, është më i madh se i personave të punësuar.

Ndërmarrjet sociale në vend me të cilat është zhvilluar intervistë janë kryesisht të varura nga asistencë e donatorëve të huaj. Ekziston mungesë e mbështetjes adekuate nga Qeveria, institucionet publike dhe vetëqeverisja lokale. Shfrytëzimi i masave aktive mbetet një potencial i pashfrytëzuar për ndërmarrjet ekzistuese sociale. Vetëm një e treta e subjekteve të hetuara kanë përdorur masa aktive të punësimit, për punë praktike, punësim të subvencionuar dhe mbështetje për vetëpunësim, hapjen e mundësive për punë për të gjithë, masë të punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve sociale ekzistuese kanë një problem me vendosjen e produkteve të tyre, nuk kanë kanale të përcaktuara të shitjes dhe informacioni në lidhje me produktet dhe shërbimet e tyre shpesh transferohet nga personi në person pa një strategji shitjeje të zhvilluar. Infrastruktura e kufizuar dhe burimet njerëzore, si dhe mungesa e makinave, kryesisht i pengon ata të arrijnë planet e tyre. Në përgjithësi, ndërmarrjet sociale nuk janë konkurruese në tregun e furnizimit publik. Shumë pak prej tyre aplikojnë në tenderët e furnizimeve publike dhe nuk i shohin furnizimet publike si burim financimi dhe sigurimit të qëndrueshmërisë ekonomike.

### **DIMENSIONI SOCIAL**


Dimensioni social i këtyre entiteteve është, në fakt, më i zhvilluari nga të tre dimensionet. Gjysma e ndërmarrjeve sociale të anketuara kanë një mision të dyfishtë social, njëkohësisht e trajtojnë problemin me tregun e jo-përfshirës të punës dhe papunësinë e grupeve të ndryshme në nevojë dhe, nga ana tjetër, kontribuojnë në ruajtjen e mjedisit. Tek pjesa më e madhe e ndërmarrjeve sociale që u intervistuan, misioni social mund të identifikohet në motivacionin për zhvillimin e ndërmarrjeve. Kështu motivet identifikohen në nevojën për t'u integruar dhe forcuar ekonomikisht qytetarët joaktiv, si gratë, prindërit vetëushqyes, persona me aftësi të kufizuara, personat me çrregullime psikiatrike, romë, qytetarët me nevojë sociale, etj. Disa prej tyre janë krijuar nga njerëzit që janë në margjina, që tregojnë për dinamikën e zhvillimit të ndërmarrjeve sociale dhe për kapacitetin e shoqërisë për vetë-organizim.

### **MENAXHIMI I MIRË**

Në mesin e entiteteve të anketuara mungon njohja e menaxhimit të mirë si concept i kapaciteteve shoqërore për zbatimin e tij. Studimi vërteton se menaxhimi i mirë formalisht praktikohet si kornizë ligjore dhe e imponon atë. Që këtu menaxhimi i mirë nuk zbatohet si pjesë e pandashme e cilësisë së punës dhe ofrimit të një shërbimi/produkti. Parimet e menaxhimit të mirë, siç është struktura e definuar e menaxhimit, ndalimi i transferimit të pronës personit juridik dhe shpërndarja e fitimeve, praktikohet vetëm në masën e përcaktuar nga korniza ligjore nën të cilën funksionon entiteti. Megjithatë, hulumtimi konfirmon se edhe kur menaxhimi i mirë vendoset nga korniza ligjore, kjo nuk praktikohet gjithmonë në praktikë, kryesisht për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore dhe njohjes së vlerës nga ana e menaxhimentit. Ndërmarrjet sociale të regjistruara si shoqata qytetare kanë parimet më të forta të menaxhimit të mirë.

# 6

## REKMANDIME





## 6.1 REKOMANDIME PËR POLITIKAT PUBLIKE

- 1) Krijimi i kornizës ligjore pozitive, e cila do ta rregullojë procesin e marrjes së statusit për ndërmarrje sociale në Maqedoninë e Veriut;
- 2) Koherenca e politikave të donatorëve dhe politikave të Qeverisë;
- 3) Krijimi i politikës tatimore pozitive dhe përfitimeve fiskale për format juridike të njohura të ndërmarrjeve sociale;
- 4) Monitorimi i zbatimit të furnizimeve të rezervuara në Ligjin e ri për furnizime publike, zbatimi i së cilës është paraparë ngaprilli 2019;
- 5) Krijimi i instrumenteve financiare inovative për mbështetjen e ndërmarrjeve sociale;
- 6) Krijimi i fondit të Qeverisë për mbështetjen e ndërmarrjeve sociale;
- 7) Aftësimi i masave aktive për punësim me nevojat e ndërmarrjeve sociale;
- 8) Zhvillim i linjave kreditore për NS, të cilat do t'i inkurajojnë drejt hapave investues për qëndrueshmëri financiare (interesi i ulët, grej periudhë prej dy deri në pesë vjet);
- 9) Stimulimi i partneritetit dhe rrjetimi në nivel lokal, komuna dhe ndërmarrjet sociale në një rajon të caktuar;
- 10) Transparenca në politikën publike për ndërmarrjet sociale, duke i përfshirë edhe masat aktive të drejtuara nga NS.

## 6.2 REKOMANDIME PËR BIZNESIN TRADICIONAL (VETËM PËR TË ORIENTUARIT DREJT PËRFITIMIT)

- 1) Përfshirja e ndërmarrjeve sociale në sistemin e furnizimit të repromaterialeve, përpunimin e pjesëve, outsourcing, transport dhe ngjashëm të biznesit tradicional;
- 2) Këmbimi i përvojave me ndërmarrjet sociale lidhur me planifikimin e biznesit, marrëdhëniet me opinionin, krijimin e një emiri të njohur, pushtimin e tregjeve, komunikimin dhe kujdesin për klientët etj.;
- 3) Partneriteti i ndërsjellë i ndërmarrjeve sociale dhe biznesit tradicional në zhvillimin e inovacioneve.

## 6.3 REKOMANDIME PËR NDËRMARRJET SOCIALE

- 1) Zgjerimi i vëllimit të veprimit në një numër më të madh të sferave shoqërore ku ka domosdoshmëri dhe hapësirë për operatorë privat;
- 2) Shfrytëzimi i instrumenteve financiare (masa aktive, kredi), që janë të aftësuara me kushtet e veprimit të ndërmarrjeve sociale në vend dhe ndarjen e tregimeve pozitive me qëllim të inkurajimit të një numri më të madh të entiteteve;
- 3) Zhvillimi i planeve për qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve sociale;
- 4) Zhvillim i sistemit për mentorimin e ndërmarrjeve sociale;
- 5) Zhvillimi i praktikës për menaxhim të mirë;
- 6) Zhvillimi i rrjetit kombëtar të ndërmarrjeve sociale për krijimin e njohurive për praktikë dhe për ndikimin shoqëror të këtyre entiteteve.

## LITERATURA E SHFRYTËZUAR

Sivcev, B. & Randelovic, V. (1966) The cooperative movement in Yugoslavia. Belgrade, pp.28-40. Ligji për furnizime publike: [http://www.bjn.gov.mk/wp-content/uploads/2019/02/ZJN\\_Sluzben-vesnik\\_24-2018-od-01.02.2019.pdf](http://www.bjn.gov.mk/wp-content/uploads/2019/02/ZJN_Sluzben-vesnik_24-2018-od-01.02.2019.pdf)

Trajkovski, I., Nikolovska, N., Kekenovski, L., Cvetkoski, C., Ivanov, G., Donevska, M., Pluskovski, V., Acevski, I. & Kartalov, H. (1999) National human development report. Macedonia 1999. Civil society in transition. Skopje: UNDP, pp.11-13. Available at: [http://hdr.undp.org/sites/default/files/macedonia\\_1999\\_en.pdf](http://hdr.undp.org/sites/default/files/macedonia_1999_en.pdf) (Last accessed on 6 March 2018).

Ilijevski, K., & Iloska, A. (2018). Social enterprises and their eco-systems in Europe: Country fiche- Former Yugoslav Republic of Macedonia. Luxembourg: European Commission. Retrieved from <http://public.org.mk/wp-content/uploads/2018/12/Social-enterprises-and-their-eco-sys-tems-in-Europe.-Country-fiche.-Former-Yugoslav-Republic-of-Macedonia-1-1.pdf>



